

UDHËZIM
Nr. 8, datë 3.9.2026

**PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN HORIZONTAL
DHE VERTIKAL BRENDË SISTEMIT TË AFP-së**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 16 dhe 20, pika 4, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat e transferimit të nxënësve brenda sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP), ku përfshihen:

- a) transferimin vertikal, nga një nivel i kualifikimeve profesionale në një nivel më të lartë;
- b) transferimin horizontal, nga një kualifikim profesional në një tjetër brenda të njëjtit nivel;
- c) transferimin e nxënësve shqiptarë dhe të huaj nga shkolla profesionale jashtë Republikës së Shqipërisë, për t’i vijuar studimet e ndërmjetme në institucionet e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave të njëvlershmërisë të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë të arsimit dhe formimit profesional që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Transferimi vertikal brenda sistemit të AFP-së

1. Nxënësi që ka përfunduar me sukses një kualifikim profesional në një nivel të caktuar të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ka të drejtë të vijojë një kualifikim profesional në nivelin më të lartë pasues.

2. Nxënësi që përfundon me sukses një kualifikim profesional të nivelit 4 të KSHK-së mund të vijojë kualifikimet profesionale të mëtejshme në nivelin 5 të KSHK-së (pas të mesme) dhe në nivelin 6 të KSHK (bachelor), sipas rrugëve të progresionit të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian për mobilitet dhe zhvillim profesional.

3. Nxënësi konsiderohet që e ka përfunduar me sukses një nivel të caktuar të kualifikimit profesional nëse është pajisur me dokumentet e certifikimit në arsimin profesional, sipas akteve nënligjore në fuqi.

4. Për t’u regjistruar në një nivel më të lartë të kualifikimit profesional, nxënësi duhet të jetë pajisur me dokumentet e certifikimit në arsimin profesional të kualifikimit profesional të nivelit paraardhës.

5. Transferimi i nxënësit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë të Arsimit Profesional (AP), bëhet me kërkesë nga nxënësi ose prindi/kujdestari ligjor i tij, e cila shoqërohet me dokumentet e certifikimit të nivelit paraardhës, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kriterëve të veçanta (nëse ka).

Neni 3
Transferimi horizontal brenda sistemit të AFP-së

1. Nëse nxënësi dëshiron të ndërrojë kualifikimin profesional, kjo mund të bëhet vetëm gjatë vitit të parë të kualifikimit profesional, por jo më vonë se dy muaj nga dita e fillimit të vitit shkollor, duke përjashtuar klasën e 10-të.

2. Përzgjedhja e kualifikimit profesional ose ndërrimi i tij bëhet me kërkesë nga nxënësi ose prindi/kujdestari ligjor i tij, si dhe shoqërohet me dokumentacionin tjetër që vërteton plotësimin e kriterëve të veçanta (nëse ka).

Neni 4

Transferimi i nxënësve shqiptarë dhe të huaj nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri

1. Nxënësit shqiptarë dhe të huaj, që kanë ndjekur studimet në shkolla profesionale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kërkojnë transferimin e tyre në vitet e ndërmjetme të kualifikimeve profesionale në shkollat e arsimit të mesëm profesional në Shqipëri, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, të cilët transferojnë studimet e tyre nga shkollat profesionale jashtë vendit për t'i vijuar ato në vitet e ndërmjetme të arsimit profesional, i nënshtrohen procesit të njehsimit të studimeve të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Procedura e njehsimit të studimeve, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), mbi bazën e programit mësimor të ndjekur dhe rezultateve të arritura, vjetore dhe/ose të vazhduara, të lëshuara nga institucioni arsimor përkatës jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të jetë i pajisur me vulë apostile ose me legalizim konsullor, për vendet që nuk aplikojnë vulën apostile, si dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Procedura e njehsimit të studimeve nis me aplikimin *online* nëpërmjet platformës *e-albania* dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar, nga prindi/kujdestari ligjor i tij. Pas përfundimit të aplikimit në platformën elektronike *e-albania*, aplikuesi dorëzon në AKAFPK, në rrugë postare, dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në pikën 3 të këtij neni, shoqëruar me kërkesën me shkrim për njehsimin e studimeve.

5. AKAFPK-ja, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, përcakton përputhshmërinë e periudhave të ndjekura, të kompetencave të fituara dhe të lëndëve/programëve të kryera, si dhe detyrimet arsimore që nxënësi duhet të përmbushë për t'u integruar në vitin përkatës të arsimit profesional në Republikën e Shqipërisë.

6. Nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, kanë të drejtë t'i transferojnë studimet e tyre në vitet e ndërmjetme në shkollat e arsimit të mesëm profesional në Shqipëri, në vitin shkollor aktual, vetëm gjatë dy muajve të parë nga data e fillimit të vitit shkollor.

7. Kur afati i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni është tejkaluar, nxënësi vijon studimet në vitin shkollor pasardhës, duke respektuar kriterin e moshës, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.

8. Vijimi i studimeve brenda vitit shkollor aktual lejohet vetëm nëse periudha nga ndërprerja e studimeve jashtë shtetit deri në momentin e njehsimit dhe regjistrimit në shkollat e arsimit profesional në Shqipëri nuk është më shumë se dy muaj, sipas dokumentacionit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

9. AKAFPK-ja krahason planin mësimor të paraqitur nga nxënësi me planin mësimor korrespondues të kualifikimit profesional ku kërkohet transferimi dhe përpilon dokumentin zyrtar të njehsimit.

10. Gjatë njehsimit të rezultateve të arritura në studimet jashtë vendit, AKAFPK-ja i referohet akteve zyrtare të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, mbi sistemin e vlerësimit/notave të vendeve të huaja, krahasuar me sistemin shqiptar të vlerësimit/notave.

11. AKAFPK-ja lëshon dokumentin zyrtar të njehsimit, brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të dokumentacionit të plotë.

12. Dokumenti zyrtar i njehsimit, i lëshuar nga AKAFPK-ja, është i detyrueshëm për shkollën e mesme profesionale për efekt të regjistrimit dhe vijimit të mëtejshëm të shkollimit të nxënësit.

13. Për nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, që kanë ndjekur studimet në një shkollë të mesme profesionale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshirojnë të transferohen në shkollat profesionale në Shqipëri, duhet të plotësojnë planin mësimor sipas strukturave të AP-së, me të drejtën për të dhënë deri në 6 (gjashtë) provime në total, për lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, përfshirë këtu edhe lëndët e mbartura nga studimet e ndjekura jashtë vendit.

14. Nëse në dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja, janë përcaktuar deri në 6 (gjashtë) lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, nxënësi regjistrohet në të njëjtin vit dhe nivel të kualifikimit profesional.

15. Nëse në dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja, janë përcaktuar më shumë se 6 (gjashtë) lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, nxënësi nuk regjistrohet në të njëjtin vit dhe nivel të kualifikimit profesional. Në këtë rast nxënësi mund të regjistrohet në klasën përkatëse të vitit paraardhës.

16. Shkolla profesionale është e detyruar të zbatojë dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja dhe të marrë masat për realizimin e detyrimeve shtesë që i caktohen nxënësit, sipas kërkesave të standardeve kombëtare të kualifikimeve profesionale.

Neni 5

Transferimi për kandidatët që certifikohen përmes procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm

1. Kandidatët që pajisen me certifikatë kualifikimi të nivelit 4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, të përfutur përmes procesit të Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm, kanë të drejtë të ndjekin programe plotësuese për përvetësimin e lëndëve të përgjithshme të arsimit të mesëm.

2. Programet plotësuese në formën e kurseve urë, organizohen nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional ose të arsimit parauniversitar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Kandidatët që përfundojnë me sukses programet plotësuese dhe plotësojnë kërkesat përkatëse fitojnë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Dispozita përfundimtare

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së.

2. Udhëzimi nr. 38, datë 21.11.2018, “Për kushtet dhe procedurat e transferimit horizontal dhe vertikal brenda sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP)”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

